



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0471**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “EJONA” SH.P.K.-Pejë, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1, me 08/11/2023, morri:

### **Vendim**

1. **Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e OE “EJONA” SH.P.K.- Pejë me nr. 2023/0471 , e datës 06/07/2023, kurse vendimi i AK “KK PRISHTINË” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “EJONA” SH.P.K.- Pejë.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 27.04.2023, “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës”. Ndërsa me datën 14.06.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “UPLIFT” L.L.C.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 180,000.00 €.

Me 19.06.2023, OE "EJONA" SH.P.K.- Pejë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.06.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.07.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "EJONA" SH.P.K.- Pejë me nr. 471/23 për lidhur me aktivitetin "Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës" me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EJONA" SH.P.K.- Pejë janë parashtruar si në vijim:

***Pretendimi :*** "AK, ka shkelur dispozitat ligjore të lartpërmendura me shpalljen fitues të OE UP LIFT. Ky OE, nuk ka përmbushur kërkesat e DT dhe të Njoftimit për kontratë, përkatësisht: 1) Në DT dhe në Njoftimin për kontratë, AK ka kërkuar: 2. Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë. Dëshmitë: 2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës m punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Ndërsa, OE UP LIFT ka prezantuar Diplomën dhe CV, vetëm për 1 teknik të ndërtimtarisë, me saktësisht z. Fadil Hasani. Pra, OE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën në DT për aftësinë profesionale dhe teknike. Në përgjigjen e AK, AK arsyetohet se për piken C nuk është kërkuar asnjë dëshmi, gjë që nuk qëndron, pasi që në DT tek dëshmitë është e cekur pika 2, pra dëshmitë e kërkuara vlejné për kërkesën e pikës 2 ku përfshihet i gjithë stafi (inxhinieret dhe tekniket). Gjithashtu është shumë e paqarte për ne se si mund të dëshmohet Profesionin dhe përvoja e punës pa diploma dhe pa CV."

***Pretendimi (II) ankuesi pretendon se:*** "OE i shpallur fitues, ka prezantuar ISO certifikatat e kërkuara tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", mirëpo këto certifikata janë të lëshuara dhe valide me datën 18.05.2023 (pra vetëm 1 ditë para hapjes së tenderëve". Andaj ky OE nuk ka dëshmuar se i plotëson KËRKESAT MINIMALE TË KUALIFIKIMIT, përkatësisht: Kërkesat e përshatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dëshmi të cilat duhet të jenë faktike PARA Datës së Njoftimit për Kontratë. Pra, ne qofte se OE "UPLIFT" nuk dëshmon se ka plotësuar kërkesat para datës së Njoftimit për Kontratë, i njëjti OE duhet diskualifikuar nga aktiviteti i prokurimit."

**Pretendimi :** “Duke pasur parasysh se OE "UPLIFT" nuk ka plotësuar çmimin e : B. PUNËT E ASHENSORIT - REKAPITULIM , AK duhet ta eliminojë nga gara për mosplotësim të listës së çmimeve dhe për mungesë të çmimit , pasi që ky është KUSHT ADMINISTRATIV.Me poshtë gjëni paramasën e OE UPLIFT ku shihet se nuk ka plotësuar paramasën tek pika e lartpërmendur. Provë tabelën. Pas gjetjes së këtyre shkeljeve dhe pas argumentimeve të OE "UPLIFT" i shpallur fitues, nuk i plotëson kërkesat në DT dhe në Listën e çmimeve, kërkojmë nga OSHP që të anulohet vendimi dhe dhënies, ta kthejë lenden në rivlerësim dhe të shpallë OE UPLIFT të eliminuar nga ky aktivitet.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “EJONA” SH.P.K.- Pejë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 51, 52, 56, 59, 69, të LPP-së dhe udhëzues 001/2023 për prokurim publik, duke propozuar OSHP-së që të anulohet vendimi dhe dhënies, ta kthejë lenden në rivlerësim dhe të shpallë OE “UPLIFT” të eliminuar nga ky aktivitet.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/07/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 471/23, ndërsa me datë 26/07/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0471 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **APROVOHET si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhënë përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE deklaron: Në pajtohemi pjesërisht me rekomandimin e ekspertit. Pajtohemi me "Përgjigje në Pretendimin Nr.1", OE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën në DT, dhe AK nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar sqarime shtese për plotësim të dokumentacionit të 2 teknikeve të ndërtimitarisë. Ndërsa, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim , AK ka mohuar kushtet e DT të vendosura nga vete ata. Nuk pajtohemi me "Përgjigje në Pretendimin Nr. 3".Pasi që OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar paramasën/rubrikat e vendosura për plotësim, dhe ky është një kusht administrativ.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “EJONA” SH.P.K.- Pejë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0471 ka vlerësuar si në vijim:

**Përgjigje në pretendimi nr. 1 është i bazuar** “Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes se tenderit është kërkuar: 2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë. 2.CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë. Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas kërkesës AK-ja ka kërkuar qe të gjitha kërkesat të përfshijnë CV, diploma, kontrata të punës apo marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt. Pjesa tjetër e kërkesës ka të bëjë me kërkesat për Inxhinierë. Përgjigja e AK-se në kërkesën për rishqyrtim se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjitha dëshmitë nuk qëndron sepse dëshmitë janë dorëzuar vetëm për një teknik të ndërtimtarisë me iniciale F.H derisa me ofertën nuk janë dorëzuar të gjitha dëshmitë për teknikun e ndërtimtarisë G.M dhe N.S. Bazuar në Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve – Paragrafi 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderin fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesa te parashtruara në njoftimin kontratë dhe në dosjen tenderit. AK-ja me datën 04.06.2023 ka kërkuar sqarime për ofertën e OE te rekomanduar për kontratë.\_Por që nuk ka përfshirë ndonjë sqarim për kriterin 9.1 & 9.2 por nuk e ka shfrytëzuar te drejtën sipas nenit 10 të UOPP-së dhe nenit 72 paragrafi 1 i LPP-së, kur informacioni apo dokumenti qe duhet te dorëzohet nga operatorët e ekonomik është ose duket te jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike autoriteti kontraktues mund te kërkojnë nga operatore ekonomik qe te dorëzoj, plotësojnë sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht qe kërkesa e tillë behën ne përputhje te plotë me parimet e trajtimit te barabartë dhe transparencës. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i bazuar.”

**Përgjigje në pretendimi nr. 2 nuk është i bazuar** “ Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me vlefshmërisë e certifikatave ISO 9001, 14001 dhe 18001(45001) eksperti shqyrtues sqaron se certifikatat e dorëzuara me ofertën e OE te rekomanduar për kontrate ne ditën e dorëzimit te ofertës kane qene me validitet. Validiteti i certifikatave sipas dëshmimeve te dorëzuara me oferte janë – ISO9001 – valide deri 17.06.2026, ISO 14001 – valide deri 17.05.2026, ISO 45001 – valide deri 17.05.2026. Për më tepër dosja e tenderit e specifikon se certifikatat duhet të jenë valide që nënkuptohet se kërkesa ka të bëjë me datën e dorëzimit të tenderit.Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pikë nuk është i

**Përgjigje në pretendimi nr. 3 nuk është i bazuar** “ Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me mosplotësimin e çmimit B. PUNET E ASHENSORIT – REKAPITULLIM dhe për këtë arsye duhet te eliminohet nga gara, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues i referohet gabimisht nenit 10 te UOPP për mungesë të çmimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë ne paramasën e dorëzuar me ofertë ka plotësuar të gjitha çmimet

*njësi sipas kërkesës së dosjes së tenderit, rekapitullimi që OE ankues i referohet është i bartur në totalin e përgjithshëm prandaj pretendimi i OE ankues se mungon çmimi nuk qëndron. Prandaj bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë nuk është i bazuar.”*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA” SH.P.K.- Pejë. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit sa i përket pretendimeve 2 dhe 3 ndërsa lidhur me pretendimin 1 paneli ka konstatuar se pajohet pjesërisht me ekspertin për arsye që do të shtjellohen si më poshtë. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA” SH.P.K.- Pejë janë pjesërisht të bazuara.

*- Konstatimet dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuara, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me numër të prokurimit 616-23-3831-5-2-1 të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Si çështje të trajtuara përcaktuese nga ana e panelit kanë qenë çështjet e ngritura nga ana e OE ankues lidhur me përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë, ku nga ana e ekspertit të

njejtat janë ndarë në 3 pretendime, pa pasur nevojën që lidhur me pretendimet ankimore 2 dhe 3 të njejtat të trajtohen në detaje, paneli vlerëson se pajtohet me konstatimet e ekspertit që lidhur me "*vlefshmërisë e certifikatave ISO 9001, 14001 dhe 18001(45001) eksperti shqyrtues sqaron se certifikatat e dorëzuara me ofertën e OE te rekomanduar për kontrate ne ditën e dorëzimit te ofertës kane qene me validitet*" e poashtu sa i përket pretendimit 3 që "*ne paramasën e dorëzuar me ofertë ka plotësuar të gjitha çmimet njësi sipas kërkesës së dosjes se tenderit, rekapitullimi që OE ankues i referohet është i bartur në totalin e përgjithshëm prandaj pretendimi i OE ankues se mungon çmimi nuk qëndron.*", poashtu duke konsideruar rrethanat që rekapitullimi në rastin konkret ka të bëjë vetëm me një pozicion që nënkupton që nuk ka pasur mbledhje të pozicioneve e poashtu çmimi i njejtë është evidentuar në që është i bartur në totalin e përgjithshëm, andaj duke qenë se çmimi i cili i referohet rekapitullimit është evident në paramasë, paneli ka gjetur mbështetje në mendimin e ekspertit se në këtë rast kështu që rrjedhimisht pretendimet ankimore të referuara klasifikohen si të pabazuara.

Lidhur me pretendimin nr 1 të paraqitur në këtë ankesë vlen të theksohet se kërkesa relevante ka qenë si në vijim:*2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë. ndërsa si dëshmi është kërkuar2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë.* Lidhur me kërkesën si në vijim, për 3 teknikë të ndërtimtarisë mund të nënkuptohet se si dëshmi janë kërkuar CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt ndërsa referencat i referohen inxhinierëve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga palët si dhe nga shkresat e evidentuara të lëndës në e-prokurimi është evidente se janë paraqitur 3 teknikë ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar, megjithatë paneli konsideron se lidhur me këto dokumente me qenë se emrat e personave të angazhuar figurojnë në ofertën e OE të rekomanduar, në këtë rast konsiderohet se mund të aplikohen dispozitat e neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zbërthyer paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit, por me kusht që ai "*...do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.*" kjo ndërlihet me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 59 të LPP i cili saktëson se lidhur me sqarimet e ofruara "*...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.*"

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Agon Ramadani**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: